



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2914/7 prot.

Datë 26.12.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1355/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.12.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 2914 prot., datë 22.11.2023 për procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*” me nr *REF-84713-10-20-2023* me objekt “*Zyre informacioni me nje ndalese - ONE STOP SHOP*” me fond limit 7,409,123.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02-11-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “SARDO” SHPK me NIPT: K13120402W  
Adresa: Fier, Lagja Apollonia, Rruga Jakov Mile zona Kadastrale 8534, Nr,9 3/5-N12.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë  
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 117 të Ligji nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për

*miratimin e rregullave për organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.10.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr *REF-84713-10-20-2023* me objekt “**Zyre informacioni me nje ndalese - ONE STOP SHOP**” me fond limit 7,409,123.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02-11-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 22.11.2023 operatori ekonomik “SARDO” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar e vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SARDO” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në datën 23.11.2023 “Formularin për Publikim” nr. 2914/2, duke pasqyruar arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “SARDO” SHPK.

II.3. Në datën 26.12.2023 operatori ekonomik “SARDO” SHPK me anë të shkresës protokolluar me tonën me nr. 2914/4 prot., datë 26.12.2023, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr *REF-84713-10-20-2023* me objekt “**Zyre informacioni me nje ndalese - ONE STOP SHOP**” me fond limit 7,409,123.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02-11-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “SARDO” SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr *REF-84713-10-20-2023* me objekt “**Zyre informacioni me nje ndalese - ONE STOP SHOP**” me fond limit 7,409,123.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02-11-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

*“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.*

*2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”.*

III.1.2. Bazuar në parashikimet e nësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqjen dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 2914 protokolli datë 22.11.2023 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr *REF-84713-10-20-2023* me objekt “**Zyre informacioni me nje ndalese - ONE STOP SHOP**” me fond limit 7,409,123.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02-11-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SARDO” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**